



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Forcës së Sigurisë
Ministarstvo Snaga Bezbednosti Ministry of Security Force

Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Rregulloren 2001/36 mbi SHCK-në, Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/01, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

KONKURS

Titulli i punës: [Shef i Qendres Koordinuese të Deminimit MACC; MFSK 2241](#)

Mbikëqyrësi: Drejtori i Departamentit të Operativës dhe Trajnimit
Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj
Niveli i pagës: A 4
Orari: I plotë
Vendi i punës: Prishtinë

Përshkrimi i punës: Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës (MFSK) ushtron mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik mbi FSK-në dhe udhëhiqet nga Ministri i FSK-së, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për sa iu përket çështjeve që ndërlidhen me FSK-në dhe poashtu do të veprojë edhe si shtabi i nivelit më të lartë të FSK-së. Detyrat e Ministrisë përfshijnë menaxhimin e personelit; menaxhimin e buxhetit dhe aktiviteteve të prokurimit; çështjet e zbulimit dhe sigurisë së FSK-së; përgatitjen e dokumenteve politike dhe ligjeve dhe rregulloreve të FSK-së; marrëdhëniet e FSK-së me popullatën civile; trajnimin, pajisjet dhe infrastrukturën e FSK-së; mbështetjen logjistike dhe mjekësore; bashkëpunimin ndërkombëtar; dhe këshillimin rreth shfrytëzimit të FSK-së për veprime (operacione) në Kosovë apo jashtë vendit. Përveç shërbyesve civil, të cilët do të përbëjnë shumicën e stafit, Ministria do të ketë edhe pjesëtarë të FSK-së të cilët do të përfshihen në detyra të posaçme me rotacion.

Qendra Koordinuese për Deminim (QKD) është njëri nga katër sektorët e Departamentit të Operativës dhe Trajnimit brenda Ministrisë. Sektorit përbëhet nga 5 punonjës, të cilët janë shërbyes civil. Qendra Koordinuese për Deminim kryen koordinimin dhe menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të deminimit humanitar të zhvilluar nga FSK dhe organizatat civile. QKD menaxhon qendrën operative për detyra të EOD-së dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me KFOR dhe Policinë e Kosovës. Në rast nevojë funksionon 24 orë pandërprerë dhe është përgjegjëse për përcjelljen e operacioneve në vijim e sipër si dhe informon autoritetet më të larta kur nevojitet.

Qëllimi i postit:

- Shefi i do të ketë përgjegjësi kryerjen e detyrave të dhëna sipas mandatit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shërben si pikë kryesore për të gjitha aktivitetet humanitare të deminimit dhe aktiviteteve tjera rreth mjeteve të pashpërthyera në mbarë Kosovën, e cila përfshin planifikimin, menaxhimin dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve të deminimit dhe mjeteve shpërthyese brenda kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe në bashkëpunim me OJQ-të, dhe KFOR-i.
- Të siguroj që mjetet e pashpërthyera dhe aktivitetet e pastrimit nga minat janë përmbushur në përputhshmëri me udhëzimet dhe Procedurat Standarde operative (PSO) për pastrimin nga minat, Pastrimin e Fushëbetejave dhe mjeteve eksplozive, domosdo në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Deminim (IMAS).
- Mbikëqyr rrjedhën ditore të Qendrës për Deminim, e cila përfshin Garanci të kualitetit, vetëdijesim rreth rrezikut nga minat dhe informimit publik, ndihmë Viktimave dhe hyrjet në bazën e të dhënave dhe komunikimeve.
- Zhvillimin e kapacitetit nacional i cili përfshin planifikimin dhe koordinimin e trajnimit të FSK-së për ndërmarrjen e operacioneve për mjetet shpërthyese.
- Mbikëqyr kontratat me OJQ-së për shërbimet e pastrimit të minave dhe përgatit kontratat për furnizim me aparaturë për mjete shpërthyese dhe pastrim nga minat.

- Prodhon prezantime për organizatat ndërkombëtare me qëllim të sigurimit të donatorëve ndërkombëtar për deminim, Vetëdijesim rreth rrezikut të minave, informimit publik dhe ndihmë viktimave.
- Vepron si udhëheqës për koordinim të takimeve me aktorë tjerë të involvuar në vetëdijesimin e rrezikut nga minat dhe dërgim të informatave në publik.
- Siguron UNMAS me freskime të vazhdueshme për situatën momentale në Kosovë dhe shtetet fqinje dhe është anëtar i Këshillit Koordinues për Deminim të Evropës Jug-Lindore (SEEMACC)
- Administrator i Sistemit Informativ Menaxhues të Deminimit (IMSMA) dhe është përgjegjës për futjen e shënimeve në bazën e të dhënave dhe freskimin e tyre për KFOR-in dhe OJQ-të.
- Mirëmban lidhjen me departamentet e OKB-së, sektorët menaxhuese për mjetet eksplozive të shteteve fqinj, Policinë Civile, KFOR-in, Ekipet për deminim të FSK-së OJQ-të dhe prestatet e shoqërisë dhe agjensioneve tjera të cilat kërkojnë mbështetje në deminim.
- Sigurohet që procedurat e sigurisë, komunikimet dhe aranzhimet e evakuimeve gjatë aksidenteve janë të përshtatshme para se të filloj puna në vendin e ndodhjes dhe gjatë kohëzgjatjes së detyrë.
- Heton aksidentet dhe incidentet në lidhje me mjetet e pashpërthyer dhe sipas nevojës bën ndryshime në PSO.
- përgjegjës për akreditimin e procedurave për akreditimin e organizatave dhe aktorëve për pastrimin e minave.
- Oficer hetues për aksidente dhe incidente me mina ose mjete të pashpërthyer.
- Menaxhim të eksplozivit dhe pajisjeve shtesë të cilat përdoren për deminim.

Shkathësitë, përvoja dhe karakteristikat tjera:

- Duhet të jetë profesional, me përvojë, i besueshëm si dhe i aftë që t'i kryej në mënyrë profesionale detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet t'i ketë shkathësitë e mira organizative.
- Duhet të përdor maturinë gjatë punës me njerëz dhe detyrën.
- Duhet të jetë i motivuar lartë dhe të ketë etik të fort pune.
- Ai/ajo duhet të jetë në mundësi që të punoj i/e mëvetësishme si dhe të punoj si ekip me punonjës të tjerë në përbushjen e detyrave të dhëna.

Kualifikimet e nevojshme:

- Diploma universitare
- Përvojë të nivelit të menaxhimit nga organizatat ndërkombëtare civile dhe ushtarake, apo në ndonjë ndërmarrje të madhe publike apo private
- Përvojë të gjatë pune në aktivitete të deminimit.
- Njohuri të gjuhës shqipe apo serbe, dhe gjuhës angleze

Kualifikimet e dëshiruara:

- Trajnim mbi përvojën operacionale.
- I certifikuar nga organizatat ndërkombëtare për Deminim Humanitar, EOD, Sigurimin e Kualitetit si dhe Menaxhimin e Lartë të Aksionit ndaj Minave.
- Certifikimi në programin për Stabilitet, Siguri, Tranzicion dhe Rikonstruktiv (SSTAR).

Si të aplikoni: Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së, apo në web-faqen e M-FSK-së, www.mkfsf-ks.org, apo www.ks-gov.net/mfsk ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet t'i dorëzohen Departamentit të Personelit personalisht, apo të dërgohen me postë në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Lagja Emshiri 1, 10000 Prishtinë, Departamenti Personelit, Kati II, (Ish-ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së)**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përbushjen e kushteve të nevojshme. **Numrat kontaktues:** Për informata plotësuese, mund të thirrni në numrin telefonik kontaktues nr.: 038 200 13 508. Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare. Data e fundit e aplikimit është 01.10.2010. Edhe aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, do të konsiderohen valide. Kandidatët duhet t'ia bashkangjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të procesit të verifikimit. Për shkak të numrit të madh aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur dhe të shënuar në listën e shkurtë do të njoftohen. Kandidatët e ftuar në intervistë duhet t'ia sjellin kopjet origjinale të dokumenteve të dorëzuara për rishikim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës i'u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.

